

URDHËR
Nr. 27, datë 2.4.2024

PËR BOTIM NË FLETOREN ZYRTARE TË KËRKESËS PËR NDRYSHIM EMRI

Bazuar në ligjin 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”; në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar; në udhëzimin nr. 90, datë 2.4.2014, “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së shpalljes, për kërkesën e ndryshimit të emrit/mbiemrit”, në urdhrin nr. 146, datë 19.5.2014, “Për caktimin e tarifave për paraqitjen e kërkesës dhe afishimin e shpalljes së kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit”,

URDHËROJ:

1. Botimit në Fletoren Zyrtare të kërkesës për ndryshimin e emrit të z. **Rejdi Mustafallari**, për një periudhë prej 15 ditësh.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PREFEKTI I QARKUT DURRËS
Emiljan Jani

PUBLIKIM KËRKESE PËR NDRYSHIM EMRI

Në shqyrtim të praktikës për ndryshimin e emrit, për shtetasin **Rejdi Mustafallari**, të paraqitur në zyrën e gjendjes civile të Njesisë Administrative nr. 4 të Bashkisë Durrës, ku shtetasi në fjalë ka vendbanimin e tij, banues në Durrës, rruga “Vaso Pasha”, ndërtesa 32, hyrja 1, pasi janë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme, në zbatim të pikës 3, të nenit 57/4, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile, të ndryshuar, sot më datë 2.4.2024, prefekti i qarkut Durrës autorizon publikimin në QBZ të kërkesës për ndryshimin e emrit të shtetasit, për shkak të papërshtatshmërisë nga Rejdi në Alexandros.

Në zbatim të nenit 57/5 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, çdo person i tretë mund të kundërshtojë kërkesën për marrjen e emrit të ri, në rast se mund të preken interesat e tij, brenda afatit prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga dita e fundit e afishimit të shpalljes.

PREFEKTI I QARKUT DURRËS
Emiljan Jani